

# DITARI MUJOR

Dhjetor, 2024/ Vol. 010


## “Shqipëria thërret!” Promovimi i mundësive të Shqipërisë nga AIDA



“Një vend me potencial të jashtëzakonshëm, mundësi strategjike dhe horizonte të reja për rritje”, AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve) fton të gjithë të zbulojnë pse gjithnjë e më shumë investitorët e huaj po zgjedhin Shqipërinë si destinacionin ideal për suksesin e tyre.

Duke ftuar investitorët të investojnë në Shqipëri, AIDA thekson se “këtu, rritja është e mirëpritur, dhe zhvillimi është një mundësi e përfaquar. Ekonomia është në zhvillim, tregjet po zgjerohen dhe zemra e vendit pulson me ambicie”.





## AIDA ka përmbyllur me sukses nismën Investors Support Days

Ky aktivitet synoi në krijimin e urave të reja të bashkëpunimit, të lehtësojë procesin e investimeve dhe të promovojë potencialet e Shqipërisë në sektorë kyç si turizmi, energjia, bujqësia dhe teknologjia.

Gjatë muajve Tetor-Nëntor në bashkëpunim me MEKI, MF, MIE, AKPA, AKBN, AIC pranë AIDA u zhvilluan tryezat e rrumbullakëta me kompanitë gjermane, italiane, turke, greke, franceze, austriake dhe hungareze.

Përveç institucioneve të qeverisjes qendrore, kjo iniciativë pati dhe prezencën e Ambasadës së Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë, Francës, Austrisë dhe Hungarisë.

Gjithashtu pjesë e saj ishin dhe Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA), Dhoma Italiane e Tregtisë, Confindustria, MUSIAD, Shoqata Greke e Biznesit në Shqipëri si dhe Advantage Austria.

Në këtë tryezë morën pjesë një total prej 120 kompanish. Për problematikat e raportuara, AIDA po i ndjek me prioritet së bashku me institucionet përkatëse, deri në zgjidhjen përfundimtare.

## AIDA, pjesë e mbledhjes së Këshilltarëve Tregtarë të Shteteve Anëtare të BE-së

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, mori pjesë në mbledhjen e organizuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, me Këshilltarët Tregtarë të Shteteve Anëtare të BE-së. Gjatë kësaj mbledhjeje, znj. Saro mbajti një prezantim gjithëpërfshirës mbi prioritetet dhe programet kryesore të AIDA-s.

Kjo mbledhje shërbeu si një platformë e rëndësishme për të forcuar dialogun dhe partneritetin midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, duke u fokusuar në promovimin e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të përbashkët.



## Takim me investitorë Turq



Takim i përbashkët me ministrat dhe AIDA-n ku u mirëpritën një grup investitorësh Turq.

Në këtë takim u vu theksi tek mundësitë e jashtëzakonshme që vendi ynë ofron për bashkëpunim dhe zhvillim falë klimës së favorshme ekonomike, politikave lehtësuese fiskale dhe pozicionit të saj strategjik në rajon. Turizmi mbetet një shtyllë kryesore, duke ofruar hapësira të mëdha për zhvillimin e resorteve moderne, ekoturizmit dhe atraksioneve kulturore, ndërsa potenciali i sipërmarrjeve dhe inovacionit premtor krijimin e një ekonomie më të qëndrueshme dhe të orientuar drejt teknologjisë.

Gjatë takimit u riafirmua mbështetja për investitorët me partneritete strategjike, duke treguar se Shqipëria është vendi i duhur për ata që kërkojnë të investojnë në sektorë me rritje të shpejtë dhe potencial të madh.



## AIDA zbaton projektin Enterprise Europe Network (EEN Albania)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e koordinatorit, ka nisur zbatimin e projektit EEN Albania, të financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti realizohet në bashkëpunim me një konsorcium partnerësh, përfshirë:

- Qendrën për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP),
- Dhomën Ekonomike të Gruas (WECA),
- Agjencinë Rajonale të Zhvillimit (RDA),
- Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Durrës (CCI Durrës),
- Agjencinë Kombëtare për Shkencë, Kërkim dhe Inovacion (AKKSHI).

Ky projekt synon të rrisë konkurrueshmërinë e NVM-ve shqiptare dhe të kontribuojë në zhvillimin e një ekosistemi ekonomik më të qëndrueshëm dhe mbështetës ndaj biznesit.



## Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Agjencinë Malazeze të Investimeve

Në dt.03/12/2024 ,pranë zyrave të AIDA, u zhvillua takimi për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe Agjencisë Malazeze të Investimeve.

Znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s dhe Znj. Snežana Đurović nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet dy agjencive homologe. Të dyja palët shprehën gadishmërinë për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh.

Duke konsideruar rëndësinë e projekteve të investimit në sektorë të ndryshëm në Shqipëri palët u dakordësuan për thellim të raporteve dhe bashkëpunimit mes agjencive homologe.



## AIDA pjesë ne Balkan Conference Value Added Textile në Sarajevë

AIDA pjesë e Dialogut Rajonal mbi Industrinë Tekstile me Vlerë të Shtuar në Sarajevë!

Nga data 3 deri më 6 dhjetor 2024, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në Takimin Rajonal për Industrinë Tekstile me Vlerë të Shtuar në Ballkan, mbajtur në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë. Gjatë këtij takimi përveç diskutimeve u bë e mundur nënshkrimi ceremonial i Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU) për të forcuar partneritetet.

Në këtë event fokusi ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe mësimave të nxjerra gjatë vitit 2024 si dhe prezantimi i planeve të aktiviteteve për 2025 me fokus në ngritjen e kapaciteteve.

AIDA mbetet e angazhuar për të promovuar bashkëpunimin rajonal, për të mbështetur industrinë tekstile vendase.



## AIDA në prezantimin e Këshillit Konsultativ të Ndërmarrjeve


AIDA mori pjesë në lançimin e Këshillit Konsultativ të Ndërmarrjeve, në zbatim të Ligjit Nr. 43/2022 "Për zhvillimin e NMVM-ve". Ky Këshill krijon një platformë dialogu mes sektorit publik dhe privat, duke synuar përmirësimin e kushteve të biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, një sektor jetik për ekonominë shqiptare.



## AIDA mirëpriti në takim Ambasadorin e Egjiptit

Drejtoresha e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, mirëpriti Ambasadorin e Egjiptit në Tiranë, Sh.T.Z. Hassan Shawky. Diskutimet u përqendruan në zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe promovimin e investimeve në sektorë strategjikë.

Gjatë takimit, znj. Saro prezantoi mundësitë që Shqipëria ofron për investitorët, ndërsa z. Shawky theksoi rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve. Të dyja palët ranë dakord për intensifikimin e kontakteve mes komuniteteve të biznesit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për të forcuar lidhjet ekonomike.



## Ftesë për pjesëmarrje në “Panairin e 5-të Ndërkombëtar të Pijeve Alkoolike”, në datat 16-18 maj 2025, Pekin.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju informon se në datat 16-18 maj 2025, Ministria e Tregtisë së Republikës Popullore të Kinës në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Kinës për Qarkullimin e pijeve alkoolike, organizon Panairin e 5-të Ndërkombëtar të Pijeve Alkoolike.

Si një treg i madh për pije alkoolike konsumi, Pekini është i gatshëm të përmirësojë zhvillimin e ekuilibruar të sektorit ndërkombëtar të pijeve. Kjo nismë synon të forcojë tregtimin e produkteve, të nxisë rritjen e tregut brenda sektorit të pijeve alkoolike, si dhe promovimin e kulturës së pijeve; – ndaj kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyer për biznese, kompani dhe sipërmarrës nga Shqipëria që të realizojnë vizita dhe takime duke patur mundësinë kështu të prezantojnë dhe promovojnë produktet e tyre alkoolike në një treg ndërkombëtar.

